



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:154558
Datë: 09.07.2024
Numri i dokumentit: 05914484

AA.nr.354/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përfaqësuar me autorizim nga K.Sh, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përfaqësuar nga Flakron Gashi, me bazën juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1892/2022, të datës 14.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1892/2022 i datës 14.04.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1892/2022, të datës 14.04.2023, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kundër të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimin i të paditurës A.nr.50/2022.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësja përmes përfaqësuesit të autorizuar K.Sh, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet si dhe vendimi nr.50/2022 i datës 14.07.2022 i

nxjerrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ose çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, me vendimin nr.50/2022, të datës 14.07.2022, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të vendimit është obliguar Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe ministri i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e tij sipas rekomandimeve të dhëna në raport. Në pikën III të dispozitivit të vendimit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra. Në pikën IV është vendosur që ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e lartcekur të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 29.07.2022, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, duke u bazuar në provat dhe dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Me arsyetim se gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi dhe në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është *e pabazuar*. Me vendimin e atakuar me padi konstatohet se aprovohet raporti i monitorimit të jashtëzakonshëm në MFPT, obligohet Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Ministri i MFPT që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij sipas rekomandimeve të dhëna në raport. KPMSHCK duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra. Nga raporti i monitorimit të jashtëzakonshëm në MFPT datë 14.07.2022 konstatohet rekomandimi: *me qëllim të kthimit të legjitimitetit rekomandojmë Kryeministrin e Republikës së Kosovës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e vendimit numër 01/79 të datës 25.05.2022 siç përcaktohet me nenin 53 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Gjykata këtu kishte parasysh se me nenin 22 të Ligjit nr.06/L-048 Për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përcaktohet:” 1. Vendimi i Këshillit është vendim

administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. 3. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës’’. Ndërsa me ligjin për Zyrtarët Publik përcaktohet neni 2:’’ 1. Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. 2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës. 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë’’, me nenin 3 të këtij ligji përcaktohet:’’ 1. Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publik; 1.2. funksionarët publikë me status të veçantë’’, po ashtu me nenin 4 përcaktohet:’’ 1. Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë’’, kurse me nenin 32 përcaktohet se’’ 3. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji’, me nenin 40 të Ligjit për Zyrtarët Publik përcaktohet:’’ 1. Pranimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese bëhet me konkurrim të organizuar për çdo pozitë të lirë. Fillimisht, kanë të drejtë të marrin pjesë në konkurrim vetëm nëpunësit civilë ekzistues të kategorisë së lartë dhe të mesme drejtuese në të gjithë Shërbimin Civil’’.

Kurse me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. ref.:AGJ 1583/20 pika 154 dhe 196 referohet neni 85 i Ligjit për Zyrtarët Publik, po ashtu gjykata e shkallës së parë kishte parasysh vendosjen sipas këtij aktgjykimi dhe atë pikën II të vendosjes ku përcaktohet: *’’TË KONSTATOJË që nenet 2 (paragrafi 3), 4 (paragrafët 3 dhe 4), 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1. 2 dhe paragrafi 2), 10 (paragrafët 1 dhe 2), 11, 14 (paragrafi 5), 15 (paragrafët 4 dhe 6), 17 (paragrafi 7), 31 (paragrafi 3), 32 (paragrafi 5), 33 (paragrafi 5), 34 (paragrafi 16), 35 (paragrafi 6), 37 (paragrafi 5), 38 (paragrafi 7), 39 (paragrafi 11), 40 (paragrafi 12), 41(paragrafi 6), 42 (paragrafët 10 dhe 11), 43 (paragrafi 13), 44 (paragrafi 4), 48 (paragrafi 9), 49 (paragrafi 6), 52 (paragrafi 7), 54 (paragrafi 6), 67 (paragrafi 11), 68 (paragrafi 8), 70 (paragrafi 8), 71 (paragrafi 7), 75, 80 (paragrafi 4), 83 (paragrafi 18) dhe 85 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk janë në përputhshmëri me: nenet 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]; 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]; 109 [Prokurori i Shtetit]; 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]; 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]; dhe me nenet 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]; 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]; 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]; 140 [Banka Qendrore e Kosovës] dhe 141 [Komisioni i Pavarur i Mediave] të Kapitullit XII [Institucionet e Pavarura] të Kushtetutës; dhe pikën III:’’ TE KONSTATOJE qe Ligji nr. 06/L-U4 për Zyrtaret Publike nuk zbatohet ne raport me: Këshillin Gjyqësor te Kosovës; Këshillin Prokurorial te Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit te Popullit; Auditorin e Përgjithshëm te Kosovës; Komisionin Qendror te Zgjedhjeve; Bankën Qendrore te Kosovës dhe*

Komisionin e Pavarur te Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetute''.

Fillimisht me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë të vendimit të atakuar Gjykata e shkallës së parë duke pasur parasysh se i njëjti *përcakton obligime për këtu të paditurën si në pikën II të të njëjtit* Gjykata e shkallës së parë u lëshua në vlerësimin e ligjshmërisë të të njëjtit në kuptim të nenit 9 të LKA-së, lidhur me nenin 22 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, po ashtu duke pasur parasysh edhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ nr.4/2023. Andaj me referim në bazën ligjore të sipër cituar konkretisht nenin 32 par.3 të Ligjit për Zyrtarët Publik konstatohet se themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji. Po ashtu duke pasur parasysh se me nenin 3 dhe 4 të po këtij ligji përcaktohen kategoritë ndaj të cilëve nuk zbatohet ky ligj e në të cilat kategori nuk përcaktohen pozitat e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, këtu Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe konstatimin si në pikën III të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Nr. ref.:AGJ 1583/20, duke pasur në vëmendje dhe konstatimin si në pikën II të këtij aktgjykimi, mbi këtë bazë Gjykata e shkallës së parë konstaton si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e atakuar të datës 14.07.2022 nr.50/2022 me të cilin aprovohet raporti i monitorimit të jashtëzakonshëm në MFPT, për faktin se me këtë raport monitorimi jepen rekomandimet lidhur me kthimin e ligjshmërisë duke konstatuar të gjeturat lidhur me mos zhvillimin e procedurës së rekrutimit sipas Ligjit për Zyrtarët Publik. Gjykata e shkallës së parë konstaton se pala paditëse në asnjë fazë të procedurës nuk ka dëshmuar se lidhur me të gjeturat si në raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm ka vepruar në kuptim të nenit 32 dhe 40 të Ligjit për Zyrtarët Publik, andaj përderisa nuk plotësohen kushtet nga neni 3 dhe 4 i Ligjit për Zyrtarët Publik Gjykata e shkallës së parë konstaton se paditësja nuk ka aplikuar dispozitat përkatëse në procedurën e rekrutimit për pozitat për të cilat janë dhënë rekomandime në raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm, e të cilat rekomandime pala paditëse nuk ka dëshmuar se iu është përmbajtur edhe sipas obligimit me pikën II të vendimit të kontestuar me padi. Në këtë kuptim Gjykata e shkallës së parë konstaton se vendimi i të paditurës është vendim i drejtë dhe i ligjshëm dhe në kuptim të nenit 20 paragrafi 5 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës institucioni përkatës i administratës publike është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit. Mbi bazën e konstatimeve si në këtë vendim të kësaj Gjykate edhe refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh formën dhe përmbajtjen e aktit por se vendimi i atakuar i referohet aprovimit të raportit të monitorimit të jashtëzakonshëm dhe i cili vendim është marrë konform kompetencave të KPMShCK, në kuptim të nenit 20 paragrafi 4 dhe se të gjeturat dhe rekomandimet referohen në raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm në MFPT. Gjykata e shkallës së parë iu referua nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i zbatueshëm në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe pretendimet e paditësit por se të njëjtat nuk i aprovoi sepse ishin në kundërshtim

me gjendjen faktike të konstatuar në këtë shqyrtim gjyqësor, pala paditëse referohet në përmbajtjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese e për të cilin pretendim Gjykata e shkallës së parë konstaton se zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese është detyrim për Gjykatën, duke pasur parasysh nenin 116 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar se *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”*, në këtë kuptim edhe kishte parasysh konstatimet e këtij Aktgjykimi dhe referimi i tyre në këtë vendim gjyqësor, po ashtu paditësi referohet në praktikën e mëparshme e që Gjykata e shkallës së parë një pretendim të tillë nuk e mori parasysh për faktin se zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi paraqet detyrim për zbatimin e tyre pa përjashtim dhe se krijimi i praktikave nuk legjitimon procedurën në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, po ashtu e paditura referohet në pretendimin se e paditura nuk ofron arsyetim dhe argumentim përse po bëhet ky devijim nga pritshmëria legjitime tanimë e krijuar me praktikën administrative rreth këtyre dy pozitive, e të cilin pretendim Gjykata e shkallës së parë nuk e mori për bazë për faktin se mjaftueshëm është arsyetuar baza ligjore përkatëse e cila rregullon procedurën e rekrutimit për këto pozita dhe rekomandimet konkrete të referuara në bazën ligjore përkatëse, andaj praktika e krijuar brenda institucioneve e referuar nga pala paditëse nuk paraqet bazë për devijim dhe mos respektimin e bazës ligjore. Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh edhe pretendimin e këtu paditësit se vendimi i atakuar nuk përmban arsyetimin, por se Gjykata e shkallës së parë konstaton se vendimi i atakuar aprovon raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm, i cili *vendim i dorëzohet institucionit bashkë me raportin e monitorimit* dhe i cili raport mjaftueshëm konstaton të gjeturat, rekomandimet dhe arsyet e aplikimit të bazës ligjore në frymën e kthimit të ligjshmërisë, andaj përkundër pranimi të rekomandimit dhe vendimit të atakuar paditësi para Gjykatës së shkallës së parë nuk ka dëshmuar respektimin e dispozitave ligjore për procedurën e rekrutimit për pozitat për të cilat e paditura ka gjetur se nuk janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore, në këtë kuptim kjo Gjykatë ka vlerësuar çështjen në merita dhe paditësi nuk ka dëshmuar para Gjykatës së shkallës së parë respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe se kthimi i çështjes te e paditura në rivendosje mbi bazën e formës së aktit të atakuar vetëm paraqet zvarritje të procedurës sepse nuk është konstatuar gjendje tjetër faktike. Se pala paditëse bie në kundërshtim me pretendimet e saj konstatohet edhe nga vendimet e paditëses të nxjerra në zbatim të vendimeve të të paditurës dhe atë vendimi nr.302/2020 datë 31.12.2020, nr.068/2021 datë 17.05.2021.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kolegji i kësaj gjykate, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar

seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, sipas përfaqësuesit së paditëses se *“gjkata e shkallës së parë gabimisht kishte konstatuar gjendjen faktike kur emërimet dhe procedurat e mëparshme të rekrutimit të bazuara në ligje të veçanta i kishte konsideruar vetëm si praktika administrative”*. Kolegji i kësaj gjykate këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, ngase konsideron se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka konstatuar se pala paditëse në asnjë fazë të procedurës nuk ka dëshmuar se lidhur me të gjeturat si në raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm ka vepruar në kuptim të nenit 32 dhe 40 të Ligjit për Zyrtarët Publik, andaj përderisa nuk plotësohen kushtet nga neni 3 dhe 4 i Ligjit për Zyrtarët Publik Gjykata e shkallës së parë me të drejtë konstaton se paditësja nuk ka aplikuar dispozitat përkatëse në procedurën e rekrutimit për pozitat për të cilat janë dhënë rekomandime në raportin e monitorimit të jashtëzakonshëm, e të cilat rekomandime pala paditëse nuk ka dëshmuar se iu është përmbajtur edhe sipas obligimit me pikën II të vendimit të kontestuar me padi. Po ashtu kolegji konstaton se gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte parasysht edhe pretendimet e paditësit lidhur me referimin për praktikën e mëparshme, mirëpo një pretendim të tillë gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk e mori parasysht për faktin se zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi paraqet detyrim për zbatimin e tyre pa përjashtim dhe se krijimi i praktikave nuk legjitimon procedurën në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, po ashtu e paditura referohet në pretendimin se e paditura nuk ofron arsytim dhe argumentim përse po bëhet ky devijim nga pritshmëria legjitime tanimë e krijuar me praktikën administrative rreth këtyre dy pozitave, e të cilin pretendim gjykata e shkallës së parë, po ashtu me të drejtë nuk e mori për bazë për faktin se mjaftueshëm është arsyetuar baza ligjore përkatëse e cila rregullon procedurën e rekrutimit për këto pozita dhe rekomandimet konkrete të referuara në bazën ligjore përkatëse, andaj praktika e krijuar brenda institucioneve e referuar nga pala paditëse nuk paraqet bazë për devijim dhe mos respektimin e bazës ligjore.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, se konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për tu aprovuar ankesa. Meqë, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate vendimi i kontestuar i të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, dhe si i tillë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysht se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të lartcekur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura një

aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.354/2023, me datë 08.07.2024

Kryetari i kolegjit,

Ramiz Kuqi